



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202100711/11

Tiranë ___/___/2021

Lënda: *Rekomandim për zbatimin me korrektesë të dispozitave ligjore lidhur me njoftimin e vendimit të gjykatës, të burgosurit në vendin e burgimit, si dhe shënimin në dispozitivin e vendimit të afatit të ankimit, gjykatës ku duhet të paraqitet ankimi dhe përlllogaritjes së afatit.*

GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

Të nderuar,

Në letërkëmbimin e mëhershëm që kemi patur jeni njohur me ankesën e të dënuarit me burgim Sh. Sh., i cili pretendon se nuk është informuar lidhur me përfundimin e procesit gjyqësor që ka të bëjë me kërkesën e tij për rishikimin e vendimit nr. 228 (10-2018-2047), datë 10.04.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me objekt bashkim dënimesh, kërkesë e cila është depozituar pranë kësaj gjykate në datë 31.01.2020. Sipas ankuesit, ai është interesuar në vijimësi për t'u informuar lidhur me çështjen objekt gjykimi, por e vetmja përgjigje që ka marrë është ajo me shkresën tuaj Nr.4637 Prot., datë 17.06.2020, nëpërmjet të cilës ankuesi vihet në dijeni se çështja po gjykohet nga gjyqtare Pajtime Fetahu.

Për verifikimin e kësaj ankese, me shkresën tonë Nr.K2/Sh2-2 Prot., datë 12.05.2021 dhe Nr.K2/Sh2-4 Prot., datë 26.05.2021 ju kemi kërkuar të na informoni nëse ka përfunduar procesi gjyqësor lidhur me kërkesën e shtetasit Sh. Sh. për rishikimin e vendimit nr. 228

(10-2018-2047), datë 10.04.2018 dhe nëse ky shtetas është njohur me vendimin e marrë të na dokumentoni respektimin e procedurës përkatëse duke na dërguar fotokopje të shkresës përcjellëse dhe të vendimit të sipërpërmendur.

Referuar dokumentacionit të ardhur pranë institucionit tonë nga Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan, me shkresën me Nr.676/1 Prot., datë 21.06.2021 rezulton se, kërkesa e të dënuarit për rishikimin e vendimit të lartpërmendur është regjistruar në datën 31.01.2020 dhe vendimi për procesin në fjalë është dhënë në datën 22.12.2020. Kjo kërkesë është shqyrtuar nga gjykata në dhomë këshillimi pa praninë e palëve, sipas parashikimeve të nenit 453/1 të Kodit të Procedurës Penale¹ dhe nuk është pranuar me arsyetimin se nuk është kërkesë rishikim vendimi, në kuptim të kriterëve të përcaktuara në nenin 450 të Kodit të Procedurës Penale². Një kopje e vendimit i është dërguar xhaxhait të të dënuarit Sh. Sh. në datën 16.04.2020, në adresën Yzberisht, Tiranë, me dëftesë komunikimi nr.83, datë 12.04.2021, megjithëse në këtë periudhë kohore kërkuesi vijonte të vuante dënimin në IEVP Rrogozhinë. Në dispozitivin e Vendimit Nr.83, datë 22.12.2020 thuhet se vendimi i njoftohet kërkuesit (të dënuarit) Sh. Sh. dhe se lejohet ankimi sipas ligjit. Në datën 04.05.2021, vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët.

Në vijim të hetimit tonë administrativ kërkua të informohemi³ nga organi juaj se kur është zbardhur vendimi i arsyetuar Nr. 83, datë 22.12.2020, arsyeja se përse nuk i është komunikuar kërkuesit (të dënuarit Sh. Sh.) në IEVP Rrogozhinë dhe si veprohet në

¹ Në nenin 453/1 “Shqyrtimi i kërkesës” të Kodit të Procedurës Penale parashikohet si më poshtë vijon:

1. “Kërkesa e rishikimit shqyrtohet nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve..”.

² Ndërsa, në nenin 450 “Rastet e rishikimit” të KPrP përcaktohet:

1. Rishikimi mund të kërkohet:

a) kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë;
b) kur vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës civile ose administrative, i cili është revokuar më pas;
c) kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi është i gabuar;
ç) kur vërtetohet se vendimi është dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjykimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale.
d) kur shkaku për rishikimin e vendimit të formës së prerë rezulton nga një vendim i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut që e bën të domosdoshëm rigjykimin e çështjes. Kërkesa paraqitet brenda 6 muajve nga njoftimi i vendimit;
dh) kur ekstradimi i të dënuarit të gjykuar në mungesë jepet me kushtin e shprehur të rigjykimin të çështjes. Kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda tridhjetë ditëve nga data kur personi është ekstraduar. Kërkesa e paraqitur brenda afatit nuk mund të refuzohet;
e) kur personi është gjykuar në mungesë sipas nenit 352 të këtij Kodi dhe kërkon rigjykimin e çështjes. Kërkesa paraqitet brenda tridhjetë ditëve nga data e marrjes dijeni. Kërkesa e paraqitur brenda afatit nuk mund të refuzohet.

³ Shkresë e dërguar nga ana jonë me Nr. K 2/Sh2-8 Prot., datë 30.06.2021.

praktikën e ndjekur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, nëse shënohet në dispozitivin e vendimeve penale afati i të drejtës për ankim dhe gjykata ku mund të drejtojnë ankimin palët e interesuara.

Në përgjigjen që kemi marrë me shkresën Nr.709/1 Prot., datë 12.07.2021 thuhet se: *“Dosja është dorëzuar në K/sekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 09.04.2021, siç rezulton nga fleta e regjistrit të dorëzimit të dosjeve. Komunikimi i vendimit është kryer në adresën e banimit që ndodhet në pjesën hyrëse të vendimit, konkretisht Fshati Yzberisht, Bashkia Tiranë dhe është dërguar nëpërmjet shërbimit postar në datën 12.04.2021. Në rast se komunikimi do të kthehej pa veprim, atëherë vendimi do të dërgohej në adresën tjetër (IEVP Rrogozhinë). Komunikimi është kthyer në datë 16.04.2021 (firmosur nga xhaxhai nëpërmjet punonjësit të postës) është llogaritur 15 ditë duke filluar nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit të firmosur, të kthyer nga posta. Për sa i përket afatit të ankimit të çështjeve penale, adm penale ky afat është përcaktuar në Kod. Sipas nenit 415 të Kodit të Procedurës Penale është 15 ditë.”*

Në analizë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, referuar nenit 139⁴ të tij, evidentojmë se njoftimi për të pandehurin e burgosur bëhet në vendin e burgimit duke i dorëzuar atij aktin dhe kjo dispozitë zbatohet edhe kur i pandehuri është i paraburgosur për një akuzë tjetër ose është duke vuajtur dënimin me burgim.⁵ Megjithëse i dënuari Sh. Sh. nuk ka patur statusin e të pandehurit kur ka paraqitur kërkesën për rishikimin e vendimit penal, çmojmë se edhe për këto raste duhet të zbatohet e njëjta procedurë njoftimi, për sa kohë ai është i izoluar në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale dhe vendndodhja e tij është e njohur. Në veçanti, për më tepër për këtë rast, konstatohet se vendimi është marrë pa praninë e të burgosurit apo përfaqësuesit të tij ligjor

⁴ Neni 139 “Njoftimi i të pandehurit të burgosur”, i KPrP konkretisht përcakton se:

“1. Njoftimi për të pandehurin e burgosur bëhet në vendin e burgimit duke i dorëzuar atij aktin.

2. Kur i pandehuri refuzon të marrë kopjen e aktit ose kur ai mungon për shkaqe të justifikuara, akti i dorëzohet përgjegjësit të institucionit, i cili për rastin e fundit njofton të interesuarin me mjetin më të shpejtë.

3. Dispozitat e mësipërme zbatohen edhe kur i pandehuri është i paraburgosur për një akuzë tjetër ose është duke vuajtur dënimin me burgim.

4. Kur i burgosuri lirohet për shkak të ndryshimit të masës së sigurimit, ai detyrohet të deklarojë ose të zgjedhë banesën. Kjo gjë shënohet në aktin e lirimit dhe i njoftohet autoritetit procedues. Kur njoftimi në banesën e deklaruar ose të zgjedhur nuk mund të bëhet, atëherë akti i dorëzohet mbrojtësit.”

⁵ Në vlerësimin tonë, duhet interpretuar për qëllimin e dispozitës që parashikon që njoftimi për personat të cilët janë nën masën e veçimit nga shoqëria të bëhet komunikimi aty, në vendin e veçimit. Për më tepër, evidentojmë faktin se prej fillimit të pandemisë e deri në datën e komunikimit nuk ka patur mundësi vizitash dhe as takimesh, çka e ka vështirësuar, për të mos thënë, e ka pamundësuar komunikimin e vendimit tek i dënuari ankues.

rreth një vit pas regjistrimit të kërkeses së të burgosurit dhe është zbardhur katër muaj pas shpalljes.

Pavarësisht se zbardhja me vonesë e vendimit të arsyetuar nuk ka qenë objekt i parashtrimeve të ankuesit, vlerësojmë se në këtë rast nuk janë respektuar afatet e përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale, neni 386 “Depozitimi i vendimit”, në të cilin parashikohet se:

“1. Vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas arsytimit, brenda afateve të parashikuara në nenin 382 të këtij Kodi. Nëpunësi i caktuar vë nënshkrimin dhe shënon datën e depozitimit.”

Ndërsa në nenin 382⁶ parashikohet se *“kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij....”*.

Edhe më parë nga institucioni i Avokatit të Popullit janë trajtuar ankesa të adresuara nga shtetas të ndryshëm për nxjerrjen me vonesë të vendimit të arsyetuar/mosnjoftimin palëve nga gjykata brenda afateve të përcaktuara në kodet e procedurës. Këto problematika, i kemi bërë prezente si pranë organeve gjyqësore përkatëse, ashtu dhe në raportet vjetorë institucionalë duke theksuar se kanë të bëjnë me thelbin e procesit të rregullt ligjor.

Jemi të vetëdijshëm për sfidat dhe situatën e krijuar në sistemin gjyqësor, sikurse vështirësitë e reja të shkaktuara nga pandemia globale Covid-19, krahas atyre me të cilat është hasur ky sistem vitet e fundit për arsye të procesit të vettingut, që kanë çuar në një mbingarkesë për autoritetet gjyqësore. Por nga ana tjetër, detyra e tyre mbështetur në legjislacionin në fuqi është të zbatojnë ligjin e garantojnë të drejtat e shtetasve në frymë dhe gërmë e për t’u bërë të drejtën e ankimit të mundur për t’u ushtruar dhe jo e kundërta.

⁶ Në nenin 382 “Përpilimi i vendimit”, përcaktohet:

1. Pas marrjes së vendimit bëhet arsyetimi i tij duke u bazuar në provat dhe ligjin penal, si dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.

2. Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

3. Kur personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij Kodi, vendimi arsyetohet brenda 15 ditëve nga data në të cilën është shpallur ose brenda 30 ditëve kur është gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

4. Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura. Në këtë rast njoftohet kryetari i gjykatës.

Megjithë mirëkuptimin, çmojmë se nuk mund të neglizhohet për asnjë moment e duhet të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme nga ana juaj për të mos cenuar të drejtën e qytetarëve për një proces të rregullt ligjor sipas garancive të parashikuara në nenin 6 të KEDNJ-së.

Ndërsa duke lexuar Vendimin Nr. 83, datë 22.12.2020, evidentojmë që në pjesën e dispozitivit thuhet se kundër këtij vendimi lejohet ankimi sipas ligjit, por nuk është shënuar afati për të ushtruar këtë të drejtë dhe gjykata ku mund të drejtohet ankuesi. Ndërkohë, në dispozitivin e një vendimi të mëparshëm të gjykatës suaj, po për këtë të burgosur, por me tjetër trup gjykues, me objekt bashkimin e dënimeve⁷ janë shënuar elementët e përmendur më lart, duke garantuar në këtë mënyrë ushtrimin e të drejtës së ankimit nga i burgosuri Sh. Sh. Referuar nenit 383⁸ “*Elementët e vendimit*” të Kodit të Procedurës Penale, nuk përcaktohet se vendimi duhet të përmbajë edhe të drejtën e ankimit, përfshirë gjykatën ku mund të paraqitet ankim, afatin dhe mënyrën e përlllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit. Duke patur në konsideratë faktin që jo të gjithë shtetasit e njohin në hollësi e detaje legjislacionin dhe gjendja jo e mirë ekonomike për shumë prej tyre u pamundëson këshillimin ligjor nga profesionistë të fushës, veçanërisht kur kemi të bëjmë me të burgosur, vlerësojmë se në praktikën e vendimeve penale, në pjesën e dispozitivit të shënohet afati i ankimit, gjykata ku mund të paraqitet ankim dhe përlllogaritja e afatit. Kjo do të garantonte efektivisht një proces të rregullt ligjor, dhe konkretisht ushtrimin e së drejtës së ankimit nga palët në proces për të kundërshtuar një vendim gjyqësor në një gjykatë më të lartë.

⁷ Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan Nr.228(13-2018-2047), datë 10.04.2018, dërguar nga ana juaj me shkresën me Nr.588/1 prot., datë 20.05.2021.

⁸ Neni 383 “Elementët e vendimit” i KPrP, parashikon:

“1. Vendimi përmban:

a) gjykatën që e ka dhënë;

b) gjeneralitetet e të pandehurit ose të dhëna të tjera personale që vlejnjë për ta identifikuar, si dhe gjeneralitetet e palëve të tjera private;

c) akuzën;

ç) parashtrimin e përmbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta;

d) dispozitivin, duke treguar nenet e zbatuara të ligjit;

dh) datën dhe nënshkrimin anëtarëve të trupit gjykues.

2. Vendimi është i pavlefshëm kur mungon dispozitivi ose nënshkrimi i anëtarëve të trupit gjykues, si dhe kur ka haptazi kontradiktë mes arsyetimit dhe dispozitivit të tij”

Referuar nenit 6 “E drejta për një proces të rregullt” të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, sa i përket rregullave proceduralë, GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se paditësit i është nxjerrë një pengesë e tepruar në të drejtën e tij për qasje në një gjykatë kur rekursi i tij në kasacion është shpallur i papranueshëm për arsye të mosrespektimit të afateve ligjore, ndërkohë që shkak i këtij mosrespektimi kanë qenë të metat e mënyrës se si e përmbushin autoritetet detyrimin e tyre të njoftimit të vendimit të dhënë nga një juridiksion më i ulët për paditësin, i cili ndodhej në burg e mund të gjendej pra se ku ishte.⁹

Në çështjen *Davran kundër Turqisë*, kjo Gjykatë ka nënvizuar se është e qartë nga ligji i brendshëm se është kryesisht përgjegjësia e autoriteteve që të bëjnë njoftimet gjyqësore një personi të ndaluar përmes administratës së burgut në fjalë. Prandaj njoftimi gjyqësor i cili ishte *lex specialis* duhet të zbatohet në mënyrë që të bëhet efektive e drejta e qasjes te gjyqtari i kasacionit dhe ushtrimi i të drejtave të mbrojtjes, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligj. Gjykata ka vërejtur të meta në lidhje me modalitetet e publikimit të vendimit të shënuar nga ankuesi, elementë që janë të mjaftueshëm që Gjykata të arrijë në përfundimin se ankuesi pësoi një ndërhyrje të tepruar në të drejtën e tij për qasje në gjykatë dhe, rrjedhimisht, në të drejtën e tij për një gjykim të drejtë, duke konkluduar në një shkelje të nenit 6 § 1.¹⁰

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut” si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”.

⁹ Udhëzues rreth nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut “E drejta për një proces të rregullt (pjesa penale)”, 2014.

¹⁰ *Davran k. Turqisë*, nr. 18342/03, 3 nëntor 2009.

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave administrative duke garantuar zbatimin me korrektesë të dispozitave ligjore lidhur me njoftimin e vendimit të gjykatës, të burgosurit në vendin e burgimit.
- Shënimin në dispozitivin e vendimit penal të afatit të ankimit, gjykatës ku duhet të paraqitet ankimi dhe përlllogaritjen e afatit, për të garantuar të drejtën e ankimit të palëve në proces, në kuadër të procesit të rregullt ligjor.
- Marrjen e masave të nevojshme për depozitimin dhe nxjerrjen e vendimeve të arsyetuara gjyqësore, sipas afateve të përcaktuar ligjorë për të garantuar të drejtën e shtetasve për një proces të rregullt ligjor.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi